



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Nr. 6/134 Prot.

Tiranë, më 12.01.2017



MIRATOHET  
MINISTËR

LINDITA NIKOLLA

**MATURA SHTETËRORE**  
**PROGRAMET ORIENTUESE**

(Provim i detyruar)

**LËNDA: GJUHË GJERMANE (Niveli B1)**

**Koordinator: LUDMILLA STEFANI, VIOLA KARAPICI**

**Viti shkollor 2016-2017**

## **1. SYNIMET E PROGRAMIT**

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës gjermane, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën gjermane si provim i detyruar, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Programi orientues është hartuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve, zhvillimet e tyre individuale duke u dhënë mundësi për sukses në atë çka i pret.

Ky program synon:

- të ndihmojë nxënësin maturant në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës gjermane si provim i detyruar në nivelin gjuhësor B1, bazuar në nivelet gjuhësore të përcaktuara në Shkallën globale të Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët;
- të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t'u dhënë orientimet e duhura nxënësve për mënyrën se si të mbështeten në këtë program dhe çfarë duhet të dinë ata për të realizuar me sukses këtë provim përmbyllës të dijeve të tyre në këtë lëndë;
- orientimin e vlerësimit që do të përfshijë 2 aftësi kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj 'të lexuarit dhe të kuptuarit' dhe 'të shprehurit me shkrim'), si dhe konceptet gjuhësore, gramatikore dhe funksionale të domosdoshëm për nivelin B1;
- të japë orientime për specialistët që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore për gjuhën gjermane si provim i detyruar.

## **2. UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT**

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, ku nxënësi në provim do të përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite.

*Kur flitet për tematikën kryesore në program nxënësit duhet që të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program (Sportarten und Unterhaltungsmöglichkeiten, Reisen, Umweltthemen, Wohnen.....)*

*Përsa i përket përdorimit të gjuhës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore dhe leksikore që ata kanë trajtuar*

gjatë viteve të shkollës së mesme. (*Passivbildung, wenn-Sätze, indirekte Rede, Zeitformen, Adverbien und Adjektive, Präpositionen, Konnektoren;*

*Wortschatz zu den Themen: Unterhaltung, Hobbys, Essen, Feiern, Urlaubsziele, Reisen, Wetterbedingungen, Umweltschutz, Wissenschaft, Technik, Mode usw...)* duke dalë nga konteksti i mësimëve ku këto probleme trajtohen. Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktikë të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, e herë tipe ushtrimesh të hapura, ku më të spikaturat janë *Lückentexte, Umformulierung der Sätze, Zuordnungsaufgaben, etj.*

*Funktionen gjuhësore* duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto nocione gjuhësore:

- Eigenes Interesse ausdrücken
- Persönliche Informationen geben
- Orte (u.Ä.)empfehlen
- Vorschläge (Kommentare) für einfache Fragen machen
- Lösungen vorschlagen
- Synonyme und Antonyme verwenden
- Vorlieben und Abneigungen äußern
- Einladungen schreiben
- Fragen und Beantworten von persönlichen Fragen
- Beschwerde- und Entschuldigungsbriefe schreiben.

*Përsa i përket të shkruarit* mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë forma të ndryshme të të shkruarit si:

- E-Mail an einen Freund oder einer Freundin über ein Reiseerlebnis.
- eine kurze Film-, Geschichte-, Romanbeschreibung, usw.
- Empfehlungsbriefe
- Narrative oder Beschreibungsbriefe oder -E-Mails
- Beschreibung eines Films, Konzert, Festival.
- Zusammenfassung eines Textes, einer Geschichte usw.

### **3. AFTËSITË DHE NJOHJET QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI MATURANT PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS ME DETYRIM NË GJUHËN GJERMANE NË NIVELIN B1.**

Nxënësi që do t'i ushtrohet provimit të Maturës me Detyrim në gjuhën gjermane duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij për çka ka marrë dhe përfituar nga të nxënëti në këtë lëndë gjatë viteve të shkollës së mesme. Përshkrimin e kompetencave dhe njohurive po i paraqesim në gjuhën gjermane pasi nxënësi është njohur me to në Portofolin Evropian të Gjuhëve ku jepet përshkrimi për çdo nivel gjuhësor.

Në **Leseverstehen**, nxënësi duhet të zotërojë këto njohuri:

Die Schülerinnen und Schüler sollen:

- unkomplizierte Sachtexte über Themen, die mit den eigenen Interessen und Fachgebieten in Zusammenhang stehen, mit befriedigendem Verständnis lesen.
- **Informationen ermitteln**, indem sie Informationen identifizieren, die verschiedene Bedingungen erfüllen;
- **textbezogen interpretieren**, indem sie den Hauptgedanken eines Textes erkennen, eine Beziehung verstehen oder die Bedeutung eines Wortes oder Satzes erschließen, auch wenn mehrere des Textes berücksichtigt und integriert werden müssen;
- **reflektieren und bewerten**, indem sie Verbindungen zwischen Informationen herstellen sowie Informationen vergleichen und erklären oder bestimmte Merkmale eines Textes bewerten; Dies muss auch dann gelingen, wenn ein genaues Verhältnis zu vertrautem Alltagswissen oder eine Bezugnahme auf weniger verbreitetes Wissen erforderlich ist;
- **Textalternativen bearbeiten** (Briefe, Flyer, Broschüre, Zeitungsartikel, Anweisungen, offizielle und persönliche Briefe)

Në **Schreiben**, nxënësi duhet të zotërojë këto njohuri:

Die Schülerinnen und Schüler sollen in der Lage sein Folgendes eigenständig zu schreiben:

Haupt Notizen, Mitteilungen und Formulare, Kreatives Schreiben, Berichte und Aufsätze, die sich wesentlich auf die untenstehenden Aspekten beziehen:

- persönliche Briefe schreiben und darin von Erfahrungen; Gefühle und Ereignisse berichten;
- Korrespondenz lesen und verstehen und dazu eine klare Stellungnahme Schreiben;
- zur Orientierung lesen und davon schriftlich berichten;
- information und Argumentation verstehen und eine eigene Argumentation verfassen;
- fernsehsendungen, Filme (usw.) verstehen und sie auch kurz beschreiben;

- unkomplizierte detaillierte Beschreibungen zu einer Reihe verschiedener Themen aus ihrem/seinem Interessengebiet verfassen;
- erfahrungsberichte schreiben, in denen Gefühle und Reaktion in einem einfachen zusammenhängenden Text beschrieben werden;
- eine Beschreibung eines realen oder fiktiven Ereignisses oder einer kürzlich unternommenen Reise verfassen;
- eine Geschichte erzählen.

Në **Sprachverwendung**, nxënësi duhet të zotërojë këto njohuri:

**a) Funktionen**

- Beschreibung der Orten
- Beschreibung von Erfahrungen und Geschichten aus der Vergangenheit
- Beschreibung von Gefühlen, Emotionen, Einstellungen
- Formulierung eigener Meinung
- Meinungsverschiedenheiten
- Beschreibung von Filmen und Büchern

**b) Verbformen und Konjugation**

- Ja / Nein-Fragen; in der Gegenwart / Vergangenheit
- Präsens
- Präteritum
- Partizip Perfekt
- Plusquamperfekt
- Vergangenheitsformen bei den unregelmäßigen Verben
- Futur 1
- Aktiv-Passivumformung
- Imperativ
- Konjunktiv II
- Reflexive Verben
- Trennbare/Untrennbare Verben
- Starke Verben
- Verbergänzungen
- Verben mit bestimmten Präpositionen
- Gebrauch des Infinitivs/der Infinitivverben

c) **Nebensätze** (Temporalsatz, Lokalsatz, Modalsatz, Finalsatz, Kausalsatz, Konditionalsatz, Konsekutivsatz, Konzessivsatz, Relativsatz, Fragewortsatz)

- **Subjektsatz:**

- **Objektsatz** : Wir erwarten Gäste. Wir erwarten, dass Gäste kommen

- **Adverbialsatz:** Heute Abend wird er sicher zu Hause sein. Wenn es Abend wird, wird er sicher zu Hause sein.

- **Attributsatz:** Der Ungeduldige Fahrer wartete nicht. Der Fahrer, der ungeduldig war, wartete nicht.

d) **Relativsätze**

e) **Satzstellung**

f) **Präpositionen**

g) **Attributbildung (Partizip I)**

h) **Steigerung der Adjektive**

i) **Deklination**

- Pronomen
- Adjektiven
- Artikel
- Partizip I und II

j) **Wortschatz zu den Themen:**

- Alltagsituationen in der Stadt, Einkaufen und Shopping
- Reisen und Dienstleistungen
- Hobbies
- Ausbildung
- Feste und Feiern
- Meinungsverschiedenheiten
- Umgangssprache

#### **4. STRUKTURA E PROVIMIT TË MATURËS SHITËTËRORE, GJUHA GJERMANE ME DETYRIM NË NIVELIN B1.**

Testi i gjuhës gjermane me detyrim në nivelin gjuhësor B1 do të jetë i ndarë në 3 seksione ku testohen:

- *Të kuptuarit e një pjesë letrare ose jo letrare*
- *Përdorimi i gjuhës që përfshin aspektet më të rëndësishme gramatikore dhe leksikore trajtuar në vitet e shkollës së mesme*

- *Të shkruarit*

<b>Pesha që zë çdo seksion në provim</b>	<b>Seksioni 1 <i>Leseverstehen</i></b>	<b>Seksioni 2 <i>Sprachverwendung</i></b>	<b>Seksioni 3 <i>Schreiben</i></b>
Në %	40%	40%	20%
Në pikë	20 pikë	20 pikë	10 pikë
Niveli 1	10 pikë	10 pikë	
Niveli 2	10 pikë	10 pikë	
Niveli 3			10 pikë

Nxënësi me *Nivelin 1, 2, 3*, do të duhet të nënkuptojë që janë pyetje të nivelit të lehtë, mesatar dhe të vështirë.

#### **5. OBJEKTIVAT E VLERËSIMIT TË NDARA DHE TË DETAJUARA SAKTËSISHT SIPAS TRI NIVELEVE.**

<b>Nr</b>	<b>seksionet</b>	<b>Pikët</b>	<b>Pesha</b>
<b>1</b>	<b><i>Të lexuarit dhe të kuptuarit</i></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjetja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë (Niv.1)</li> <li>- Reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij (Niv.1)</li> <li>- Perifrazimi i një fraze ose shprehjeje shkëputur nga teksti (Niv.2)</li> <li>- Nxjerrja e një kuptimi të përgjithshëm dhe e moralit të pjesës, ose idesë qendrore shprehur në gjuhë të thjeshtë (Niv.3)</li> <li>- Gjetja e elementëve që justifikojnë përgjigjen e dhënë (Niv.2)</li> <li>- Plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit (Niv.1)</li> <li>- Gjetja e fjalëve referuese (Niv.2)</li> </ul>	<b>20 pikë</b>  3 pikë 3 pikë  3 pikë  2 pikë  3 pikë  3 pikë 3 pikë	<b>40%</b>
<b>2</b>	<b><i>Gramatika</i></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kohët e foljeve (Niv. 1)</li> <li>- Shkallët e mbiemrave, (Niv. 1)</li> </ul>	<b>10 pikë</b>  1 pikë 1 pikë	<b>20%</b>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lidhëzat, (Niv. 1)</li> <li>- Përemrat lidhorë të thjeshtë, (Niv. 1)</li> <li>- Parafjalët (Niv. 2)</li> <li>- Vendosja e gjymtyrëve në fjali, (Niv. 2)</li> <li>- Format pësore, (Niv. 2)</li> <li>- Ligjërata e zhdrejtë, (Niveli 3)</li> <li>- Foljet frazale, (Niveli 2)</li> <li>- Fjalitë e nënrenditura (Niveli 2)</li> </ul>	<p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p>	
<b>3</b>	<b><i>Fjalori</i></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mënyrat e fjalëformimit (Niveli 2)</li> <li>- Përdorimi i një fjalorit në raport me temën (Niveli 1)</li> <li>- Grupet sinonimike (Niveli 2)</li> <li>- Shndërrime fjalish duke ruajtur kuptimin fillestar (Niveli 2)</li> </ul>	<p><b>10 pikë</b></p> <p>2 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>2 pikë</p>	<b>20%</b>
<b>4</b>	<b><i>Të shkruarit</i></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimi i temës (Përmbajtja)</li> <li>- Organizimi</li> <li>- Saktësia në gramatikë</li> <li>- Fjalori i përdorur</li> <li>- Respektimi i rregullave të shkrimit (shenjat e pikësimit, strukturat e ndërtimit të frazave dhe fjalive, gërmat kapitale, etj.)</li> </ul>	<p><b>10 pikë</b></p> <p>2 pikë</p> <p>2 pikë</p> <p>2 pikë</p> <p>2 pikë</p> <p>2 pikë</p>	<b>20%</b>
<b><i>Totali</i></b>		<b>50 pikë</b>	<b>100%</b>

## **6. TIPE USHTRIMESH QË NXËNËSI DUHET TË PUNOJË PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS ME DETYRIM NË GJUHËN GJERMANE.**

### **a) Tipet e ushtrimeve që mund të jepen në *Leseverstehen*:**

- *Richtig oder falsch*
- *Multiple Choice* (Antwort-Wahl Verfahren) (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna)



- *Überschriften oder Abschnitte zuordnen* (vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve)
- *Lückentext* (plotësimi i kuptimit të një fjalie ose fraze në një tekst të caktuar mbi një temë të caktuar)
- *Offene Antworten* (përgjigje të hapura ku nxënësi shpreh mendimin dhe vlerësimin e tij rreth një çështjeje ose pyetjeje të caktuar rreth tekstit)
- *Kurze Antworten* (përgjigje të shkurtra, të dhëna me fraza ose fjali të shkurtra)
- *Kombinationsaufgaben* (Bashkimi i një pjese teksti me një pjesë tjetër që mungon dhe e plotëson kuptimin e tij në tërësi)

#### **b) Në përdorimin e gjuhës:**

Tipet e ushtrimeve që do të përdoren në provimin me detyrim në gjuhën gjermane mund të jenë të tipeve si më poshtë:

- *Multiple Choice* (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna);

*Beispiel:*

Wozu brauchst du denn so viel Sahne?

Wozu wohl? Natürlich \_\_\_\_\_ Kochen.

- A) damit
- B) zu
- C) für
- D) zum

- *Lückentext* (plotësimi i fjalisë me gjetjen e një fjalie ose fraze të duhur me të cilën ka kuptim fjalia ose fraza);

*Beispiel:* Ergänzen Sie die Artikel und Pronomen:

- 1) Es folgte \_\_\_\_ neue Epoche in \_\_\_\_ Sprachgeschichte.
- 2) Auch sie wurde entscheidend von \_\_\_\_\_ Quellen geprägt.

- *Umformulierungen* (shndërrim fjalish duke e strukturuar ndyshe, por duke i ruajtur kuptimin fillestar);

*Beispiel:*

Da er neugierig gewesen ist, hat er das Feuer angezündet.

Aus Neugier hat er das Feuer angezündet.

- *Wortbildung* (ushtrime mbi mënyrat e fjalëformimit)

**Ordnen Sie die Vorsilben den passenden Adjektiven zu.**

<b>A</b>	<b>B</b>	
mobil	im	_____
real	ir	_____
legal	il	_____
normal	in	_____
direkt	a	_____

**c) Në temën me shkrim**, nxënësi duhet të jetë i aftë të prezantohet me punë të tilla si:

- Email formal ose joformal
- Letër formale ose joformale
- Përshkrim
- Ritregim
- Përmbledhje
- Ese përshkruese